



# BALKAN TENDER WATCH

## TË SHKURTËR PËR MEDIAT

**Nëntor 2018**



*„Kjo përmbledhje e shkurtër u prodhua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e saj është përgjegjësi e vetme e koalicionit Balkan Tender Watch (BTW) dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.“*

## Tre hapa për rrëzimin e 'mbretërisë së tenderëve'

Një "fron" i udhëhequr nga tre persona, në 10 vjetet e fundit, ka vendosur për mënyrën qysh shpenzohet paraja publike në Kosovë. Fatin e gjithë tenderëve milionësh, në të cilët kishte ankesa, e vendosin tre persona, të cilët emërohen nga Kuvendi i Kosovës. Fjala është për bordin e Organit Shqyrtues të Prokurimit që në Kosovë është shndërruar në superfuqi kur është fjala për vendosjen se si do të shpenzohen paratë publike.

OSHP-ja që njihet si gjykata e tenderëve merr vendime të formës së prerë kur është fjala për tender, mënyrën e shpenzimit të parasë publike. Vendimet e këtij organi duhet të zbatohen nga të gjitha Autoritetet Kontraktuese, pra gjithë institucionet e Kosovës. Palët e pakënaqura me vendimet e OSHP-së, duke përfshirë bizneset, mund t'i drejtohen Gjykatës për të kërkuar dëmin apo fitimin e humbur. Fakti që Gjykatat vonohen me vite derisa të marrin një vendim të zbatueshëm, i ka dhënë fuqi edhe më shumë OSHP-së. Pak kush ka shpresë dhe vullnet e kohë që t'i drejtohet Gjykatës për të rivendosur drejtësinë. Ankesën në gjykatë shumë pak biznese e ndjekin, marrë parasysh që ankesa nuk e ndal procedurën e prokurimit dhe kontrata mund të nënshkruhet e zbatohet.

Edhe vendimet e Gjykatës e kanë rritur indirekt fuqinë e OSHP-së. Gjykata ka marrë vendim që konstaton që OSHP ka bërë shkelje ligjore dhe e kanë urdhëruar që të kthej një tender në rivlerësim. Madje kjo kërkesë që lënda të kthehet në rivendosje në OSHP është bërë për një tender përkundër që kontrata që ishte kontest ishte afër përfundimit. OSHP-ja e zbaton formalisht vendimin e Gjykatës duke e rivlerësuar vendimin, mirëpo duke vendosur prapë njëjtë. Kështu kishte vepruar disa vite më herët në rastin e tenderit për pastrim të QKUK-së.

Fuqia e anëtarëve të bordit të OSHP-së është rritur edhe më shumë, pasi nga themelimi i saj më shumë kohë ka funksionuar me tre anëtarë se sa me pesë anëtarë siç e parashikon ligji i Prokurimit Publik. Kjo ka bërë që pushteti i këtyre tre personave të jetë tepër i madh. Ata vendosin për secilin tender që kalon nëpër OSHP. Lidhja e pazareve është shumë më e madhe kur është një numër kaq i vogël i anëtarëve, pra prej 3 personave. Fundja, nuk po zbatohet ligji i Prokurimit i cili kërkon që tenderët me vlerë të madhe të shqyrtohen nga paneli pesë anëtarësh. Për më tepër edhe sikur gjithçka të ishte perfektë, tre anëtarë e kanë të pamundur t'i shqyrtojnë në mënyrë meritore gjithë ato ankesa, të cilat kanë dokumente voluminoze.

## **Cila është zgjidhja?**

Hapi i parë që duhet të bëjë Kuvendi i Kosovës është ndryshimi i Ligjit të Prokurimit Publik duke ia rritur numrin e anëtarëve të bordit të OSHP-së në 10 anëtarë. Duke i pasur 10 anëtarë, OSHP-ja do të mund të funksiononte normalisht. 10 anëtarë ofrojnë shumë mundësi për të minimizuar shkeljet e qëllimshme ose të paqëllimshme që mund t'i bëjë OSHP-ja. E para, rotacioni që do të mund të përdorej për ndarjen e lëndëve do të bënte të pamundur që një anëtarë i bordit të ketë të garantuar vendin në panel në një tender të caktuar. Pra, e zvogëlon mundësin për marrëveshje paraprake. E dyta, do të parandalojë “sindromin” e bordit tre anëtarësh. Edhe nëse ndonjë prej anëtarëve të bordit suspendohet (siç ka ndodh shpesh në të kaluarën), jep dorëheqje apo vdesë, panelet shqyrtuese nuk do të ndikohen, pasi ato do të kenë numrin maksimal prej 5 anëtarëve.

Hapi i dytë, për të bërë funksionale Gjykatën e Tenderëve është vendosja e kamerave për xhirimin e të gjitha seancave. Dikush mund të thotë, “Jo, se aty fliten sekrete afariste”. Por, këto kamera edhe mund të mbeten sekrete, njëjtë qysh mbetet vendimi i panelit shqyrtues të OSHP-së. Por, xhirimi i seancave do të vije në shprehje nse ka ankesa në Gjykatë, apo nëse ka hetim penal për një proces të prokurimit. Pra, këto xhirime do të mund të shikoheshin vetëm me vendim të gjykatës. Ky është opsioni më ekstrem. Një opsion i parapëlqyer do të ishte që pas secilës seancë, Operatorët Ekonomik të deklarohen për pjesët e seancës që duhet të mbulohet meqë janë folur fshehtësi afariste. Kërkesa e Operatorëve Ekonomik nuk mund të miratohet blanko, por normalisht shqyrtohet në bazë të ligjeve në fuqi për sekretin afaristë.

## **Praktika Legjislative**

Njëra prej të metave të OSHP-së është fakti që nuk është ndjekur asnjëherë praktika legjislative. OSHP-ja, në shumë raste, ka marrë vendime të ndryshme për të njëjtin pretendime. Kjo ngjallë dyshimin se paneli shqyrtues i OSHP-së e interpreton ligjin ashtu siç i nevojitet dhe jo në bazë të një interpretimi të unifikuar dhe duke u bazuar në vendimet e mëparshme. Dikush edhe mund të thotë se vendimet e kaluara kanë qenë gabim e tash qysh me u mbështet në to. Por, duhet të ketë një shqyrtim cilësorë të secilit vendim për të parë nëse vendimi ka qenë i drejtë apo jo. Pra, nëse për një shkelje, OSHP-ja thotë se janë devijime të vogla ligjore dhe e lejon Autoritetin Kontraktues me vazhdu me procesin e prokurimit, atëherë kjo rregull duhet të vlejë gjithmonë. Krijimi i praktikës legjislative e ndihmon transmetimi i seancave të OSHP-së dhe sensibilizimi i Operatorëve Ekonomik që gjithmonë të thirren edhe në vendime të OSHP-së, pra në raste të ngjashme që janë vendosur nga Paneli, për të përforcuar kërkesën e tyre për kthim të lëndës në rivlerësim apo ri tenderim.

Në formatin aktual, dyshimet në vendimet e Organit Shqyrtues të Prokurimit gjithmonë do të jenë më të mëdha, edhe nëse tre anëtarët do të bëjnë punën më të mirë të mundshme. Duke emëruar në bordin e OSHP-së njerëz në bazë të meritokracisë dhe duke e rritur edhe më shumë transparencën, sado pak do të mund t'i kthehet kredibiliteti i këtij institucioni.